



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. 57/2015

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtar Hajriz Hoti, në konfliktin administrativ të paditës-propozuesit Komuna e Prishtinës – Komisioni Komunal i Aksionarëve të Komunës së Prishtinës për ndërmarrjen publike KRM ‘Pastrimi’ Sh.A., të cilin me autorizim e përfaqëson Genc Sherifi, kundër të paditurit Bordi i Drejtorëve të KRM ‘Pastrimi’ Sh.A. për shkak të anulimit të vendimit, me propozim për shtyerjen e ekzekutimit të të njëjtit, jashtë seance me dt. 16.01.2015, merr këtë,

A K T V E N D I M

APROVOHET propozimi i paditës-propozuesit Komuna e Prishtinës – Komisioni Komunal i Aksionarëve të Komunës së Prishtinës për ndërmarrjen publike KRM ‘Pastrimi’ Sh.A. në Prishtinë dhe shtyhet ekzekutimi i vendimit të Bordit të Drejtorëve të KRM ‘Pastrimi’ Sh.A. i datës 20.12.2013, deri në marrjen e aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

A r s y e t i m

Propozuesi Komisioni Komunal i Aksionarëve të Komunës së Prishtinës për ndërmarrjen publike KRM ‘Pastrimi’ Sh.A. nga Prishtina më dt. 13.01.2015 ka ushtruar padi në këtë Gjykate kundër të paditurit Bordi i Drejtorëve të KRM ‘Pastrimi’ Sh.A. në Prishtinë për anulimin e vendimit të të paditurit të datës 20.12.2013, me propozim për shtyerjen e ekzekutimit të tij.

Për të vlerësuar propozimin e paditësit për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit, gjykata iu referua nenit 22 par. 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ku përcaktohet se “me kërkesën e paditëses, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t’i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyerja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyerja do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar”.

Ndërsa me paragrafin 6 të të njëjtit nen përcaktohet se “paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyerjen e ekzekutimit të aktit, deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”.

Gjykata duke vlerësuar propozimin e paditësit, vëren se paditësi nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e ka bërë të besueshëm propozimin e tij, se ekzekutimi i vendimit të goditur me padi do t’i sjellë dëm, i cili vështirë do të riparohej dhe se shtyerja e ekzekutimit të vendimit, nuk është në kundërshtim me interesin publik. Në këtë kuptim Gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet nga neni 22.6, i Ligjit për Konfliktet Administrative, për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit kontestues.

Mbi këto arsye, gjykata duke u bazuar në nenin 22.7 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e aprovuar propozimin e paditësit.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr.57/2015, datë 16.01.2015.

Këshillë juridike:

kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

